

LIGJ
Nr.9734, datë 14.5.2007

PËR TURIZMIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe i rregullave që veprojnë në fushën e turizmit, si dhe vendosja e zhvillimi i standardeve të shërbimeve turistike dhe të shërbimeve të tjera të lidhura me të.

Neni 2

Objekti

Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, persona juridikë e fizikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike, përcakton të drejtat e detyrimet e subjekteve pjesëmarrëse në këto veprimtari, në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që lidhen me fushën e turizmit.

Neni 3

Subjektet dhe fusha e zbatimit

1. Personat juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, e zhvillojnë veprimtarinë turistike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Personat juridikë dhe fizikë, që zhvillojnë veprimtari turistike biznesi, në baza kontraktuale, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij për turizmin, për sa kohë që ato nuk bien në kundërshtim me ligjin e vendit ku zhvillohen.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjent terreni” është personi që përgatit shërbime turistike për klientët e një operatori turistik ose të organizatorëve të tjerë, vendi i ushtrimit të biznesit të të cilëve është jashtë Republikës së Shqipërisë. Ky term vlen, gjithashtu, edhe për “operatorë turistikë hyrës”.

2. “Agjent udhëtimi” është personi që, zakonisht ose rregullisht, merr përsipër t'u sigurojë personave të tjerë, kundrejt një çmimi, një ose disa shërbime të veçanta, që mundësojnë një udhëtim turistik ose qëndrim të përkohshëm. Këto shërbime përfshijnë, por që nuk kufizohen në:

a) shitjen e paketave të udhëtimit në emër të operatorëve të udhëtimit vendas ose ndërkombëtarë;

b) përgatitjen e dokumenteve të udhëtimit, në përputhje me rregulloren në fuqi;

c) përgatitjen për transportin dhe/ose akomodimin e udhëtarëve.

3. “Akomodim turistësh” është shërbimi që u ofron vizitorëve akomodim fjetjeje, në mënyrë tregtare ose biznesi, i përshtatshëm për t’u regjistruar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. “Burime turistike” janë komponentët mjedisorë, natyrorë dhe antropologë, që janë bërë të njohura dhe janë regjistruar si burime turistike për cilësinë dhe veçoritë e tyre e që janë kapitalizuar përmes turizmit.

5. “Fshat turistik” është një strukturë e organizuar në formë fshati, me përqendrim të burimeve turistike, i klasifikuar në përputhje me standardet e miratuara për zhvillimin e turizmit e që gëzon privilegje të caktuara, sipas dispozitave të këtij ligji.

6. “Vend turistik” është një vend me burime turistike natyrore, me një epërsi të veçantë, i cili ka kapacitet për të tërhequr turistë, vendas dhe të huaj, me një infrastrukturë të harmonizuar dhe mjedise moderne që plotësojnë kërkesat e turistëve.

7. “Guidë turistike” është personi, i cili, kundrejt pagesës, shoqëron turistët, duke u përshkruar dhe/ose shpjeguar atyre arkeologjinë, historinë, natyrën, arritjet dhe kulturën e popullit të asaj treve.

8. “Hotel” është një ndërtesë, që ka jo më pak se 6 dhoma në dispozicion për akomodimin e përshtatshëm të udhëtarëve, ku ofrohet ushqim, pije dhe, nëse kërkohet, akomodim për çdo udhëtar, pa ndonjë kontratë të veçantë, që është i gatshëm të paguajë shumën e shpallur për shërbimet dhe mjediset. Mjediset duhet të përdoren për qëllime të ushtrimit të zanatit të hotelierit.

9. “Hotelier” është personi që zotëron, është pronar i autorizuar ose qiramarrës i një hoteli.

10. “Hua” është dhënia e parave, sipas një programi asistence financiare, përgatitur nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas këtij ligji, me kusht kthimin e tyre me ose pa interes.

11. “Grant” është një e ardhur në para, në formë dhurimi, e parashikuar në një program asistence financiare, i përgatitur sipas nenit 9 të këtij ligji, pa kusht kthimi.

12. “Njësi akomoduese” është ndërtesa ku ofrohet akomodim turistësh.

13. “Pronar i njërive akomoduese” është personi që zotëron, është pronar i autorizuar ose qiramarrës i një njësie akomoduese.

14. “Operator turistik” është një person që zakonisht ose rregullisht, kundrejt një çmimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndërmjetës, organizon udhëtime ose paketa udhëtimesh për publikun, të cilat përfshijnë dy ose më shumë nga shërbimet e mëposhtme:

a) udhëtime me shoqërues;

b) akomodim;

c) argëtim;

ç) transport.

15. “Operator turistik hyrës” është agjent terreni.

16. “Operator turistik i jashtëm” është një operator turistik, që ofron shërbimet e përshkruara në përkufizimin “operator turistik”, por me destinacion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

17. “Kontratë” është marrëveshja që lidhet ndërmjet klientit/konsumatorit të paketës turistike dhe shitësit të paketës apo shërbimit turistik.

18. “Organ publik” është çdo person juridik publik, sipas Kodit Civil, i përcaktuar i tillë në funksion të këtij ligji.

19. “Ofrues transporti për turistët” është një person që u ofron transport vizitorëve me mjete motorike, lundruese, anije apo varka, avion, helikopter ose me kafshë.

20. “Paketë turistike” është një paraorganizim i kombinimit të jo më pak se dy nga shërbimet e përmendura në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç” të pikës 14 të këtij neni, si transporti, akomodimi dhe shërbime të tjera plotësuese, kur shitet ose ofrohet për shitje me çmim të përfshirë dhe kur ky shërbim mbulon një periudhë më shumë se njëzet e katër orë.

21. “Pikë turistike” është një destinacion i krijuar për një kohë të gjatë, i hapur për publikun për zbavitje, argëtim, çlodhje, interes të veçantë, edukim, disa ose të gjitha nga këto, që tërheq vizitorë, ditorë ose turistë, apo një ngjarje që zhvillohet në një vend, i cili përdoret për një kohë të gjatë ose përkohësisht për këtë qëllim, duke shfrytëzuar natyrën argëtuese dhe çlodhëse.

22. “Restorant” është një ndërtesë, ku i ofrohet ushqim dhe pije për konsumim, brenda mjedisit, çdo udhëtar që është i gatshëm të paguajë shumën e shpallur të ushqimeve dhe pijeve.

23. “Shërbime turistike” janë shërbimet që u ofrohen turistëve nga sipërmarrjet turistike.

24. “Sipërmarrje turistike” është një person i angazhuar në veprimtarinë e agjencisë së

udhëtimit, operatorit turistik, agjencisë në terren, transportit të turistëve, prodhimit ose shitjes me pakicë të suvenirëve apo punimeve artizanale, pikat e tërheqjes së vizitorëve, sportet ujore ose në ndonjë biznes tjetër të licencuar si sipërmarrje turistike nga ministri përgjegjës për turizmin.

25. “Turizëm” janë veprimtaritë e personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm për jo më shumë se 1 vit radhazi për argëtim, punë dhe qëllime të tjera, që nuk lidhen me ushtrimin e ndonjë veprimtarie, që paguhet nga vendi i vizituar dhe, gjithashtu, i referohet sektorit të ekonomisë kombëtare me funksione komplekse, që lidh një numër mallrash dhe shërbimesh, të cilat u ofrohen për konsum këtyre njerëzve.

26. “Turizëm i qëndrueshëm” është veprimtaria turistike që përmbush nevojat e turistëve ekzistues dhe të rajoneve pritëse, ndërsa mbron dhe rrit mundësitë për të ardhmen; veprimtaria që çon në administrimin e të gjitha burimeve, në mënyrë që nevojat ekonomike, shoqërore dhe estetike të përmbushen, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, edhe integritetin kulturor, procesin thelbësor ekologjik, diversitetin biologjik dhe sistemet e përkrahjes jetësore.

27. “Turist” është një vizitor, i cili qëndron të paktën në një ndalesë për një natë në një hotel ose në akomodime të tjera turistësh dhe/ose një konsumator i shërbimeve turistike.

28. “Turizëm vendas” janë veprimtaritë turistike të ndërmarra nga shtetas shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

29. “Turizëm i brendshëm” janë veprimtaritë turistike të ndërmarra nga shtetas joshqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nga turizmi vendas.

30. “Turizëm i huaj” janë veprimtaritë turistike të ndërmarra nga shtetas joshqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

31. “Turizëm kombëtar” janë veprimtaritë turistike të ndërmarra nga shtetas shqiptarë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

32. “Ekskursionist” është një vizitor që udhëton për qëllime turizmi, pa kaluar natën në vendin që viziton.

33. “Veprimtari turistike” është veprimtaria që zhvillohet në bazë të kërkesës dhe ofertës.

34. “Trashëgimia turistike” janë burimet turistike natyrore dhe antropologjike, baza materiale dhe teknike, infrastruktura e përgjithshme, infrastruktura e turizmit dhe mallrat për konsumim nga turistët.

35. “Burime kulturore” janë veprimtaritë kulturore që zhvillohen në një vend të caktuar.

36. “Turizëm kulturor” janë veprimtaritë turistike, që kanë si qëllim kryesor vizitat në burimet turistike të një vendi, qyteti, fshati ose rajoni të caktuar.

37. “Udhëtar” është një person, që nuk është banor i një hoteli, bujtine, hoteli familjar ose akomodimi tjetër turistësh, i cili kërkon të qëndrojë në hotel, bujtinë, hotel familjar për t'u akomoduar për shërbime dhe lehtësi të këtij lloji ose për ushqime dhe pije, sipas mundësisë dhe për të cilat ai është i gatshëm të paguajë. Nuk ka rëndësi çfarë mjeti transporti përdor, apo nëse ka përdorur apo jo një mjet të tillë.

38. “Vizitor” është çdo person që udhëton në një vend të ndryshëm nga rezidenca e vet e zakonshme për më pak se 12 muaj dhe që nuk ka si qëllim të ndërmarrë veprimtari që paguhet në vendin e vizituar.

39. “Zonë e zhvillimit të turizmit” është zona, e cila ka burime turistike të mjaftueshme për zhvillimin e turizmit dhe që do të jetë subjekt i kufizimeve të planifikimit.

40. “Licencë” është certifikata që lëshohet nga ministria përgjegjëse për turizmin, në përputhje me dispozitat e nenit 28 të këtij ligji.

41. “Ministri përgjegjës për turizmin” është autoriteti përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë shtetërore të turizmit.

42. “Ministria përgjegjëse për turizmin” është personi juridik publik që mbështet, në aspektin teknik, veprimtarinë shtetërore të ministrit përgjegjës për turizmin.

43. “Aktivitete kulturore” janë arti, kërcimi, drama, festivalet, prodhim filmash, folklori, letërsia, muzika, historia gojore, kënga, prodhime të radios, televizionit dhe video e prodhime të tjera elektronike dhe të kompjuterizuara, çdo lloj kombinimi i tyre ose aktivitet tjetër që kremton, ruan, zhvillon ose nxit kulturën e popullit shqiptar dhe që pëlqehet nga turistët.

44. “Punë artizanale” janë punë të bëra me dorë për të prodhuar artikuj për shitje për turistët dhe përfshin punime druri, punime argjendi, qëndistari, punime në llak/vernik, prodhime xhami,

kostumet, gdhendje, punime guri, piktura, qeramikë, shportari dhe ndonjë lloj tjetër punimi të emërtuar si i tillë nga ministria në ndonjë buletin të botuar në Fletoren Zyrtare.

45. “Suvenir” janë mallra, harta, fotografi, kartolina dhe mallra të tjera të këtij lloji, të tjera nga ato të bëra me dorë, që u shiten turistëve si përkujtues të vizitës së tyre në Shqipëri.

KREU II PARIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË TURIZMIT

Neni 5 **Parimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit**

1. Turizmi dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me të mbështeten në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me trashëgiminë kulturore kombëtare, traditat dhe zakonet e popullit shqiptar, si dhe në parimin e mbrojtjes e të përdorimit të njëjtë të burimeve turistike.

2. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit sigurohet nëpërmjet:

a) organizimit dhe zbatimit të planifikimit turistik në nivel vendor, si pjesë përbërëse e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në nivel kombëtar;

b) përfshirjes së organeve të ndryshme publike, të sektorit privat, shoqatave profesionale, tregtare e të mbrojtjes së konsumatorit, të OJF-ve përkatëse, si dhe të popullsisë në procesin e planifikimit;

c) planifikimit dhe administrimit turistik, duke respektuar mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore;

ç) shpërndarjes së barabartë të avantazheve dhe të kostove ndërmjet promovuesve të turizmit, komunave, bashkive, qarqeve dhe popullsisë në vendet pritëse;

d) informimit, arsimimit, motivimit dhe përfshirjes së popullsisë vendase në procesin e krijimit të lehtësive të turizmit;

dh) vlerësimit paraprak të projekteve me përfitim të lehtësive, sipas programeve të financimit dhe të ndikimeve të mundshme të tyre pas zbatimit;

e) përfshirjes së popullsisë vendase në hartimin e programeve të përbashkëta për zhvillimin e turizmit.

3. Institucionet përgjegjëse për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit:

a) sigurojnë dhe garantojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve turistike, mbrojtjen e ruajtjen e mjedisit, masa mbrojtëse dhe monitorim, në përputhje me strategjitë kombëtare dhe lokale, si dhe programet vjetore të turizmit të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

b) promovojnë interesin publik në zonat e zhvillimit të turizmit;

c) garantojnë sigurinë, mbrojtjen e të drejtave, të interesave dhe pronën e turistëve;

ç) mbrojnë, zhvillojnë dhe përdorin burimet turistike, për të maksimizuar potencialin e tyre ekonomik dhe administrimin në mënyrë uniforme për përmirësimin e tyre për zhvillim të qëndrueshëm.

KREU III STRUKTURAT INSTITUCIONALE PËR TURIZMIN

Neni 6 **Ministria përgjegjëse për turizmin**

Ministria përgjegjëse për turizmin ka këto detyra:

a) zbaton parimet bazë të zhvillimit të turizmit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në këshillim dhe bashkëpunim me komunitetin e biznesit të turizmit;

b) paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave linjën e veprimit dhe strategjinë kombëtare të turizmit;

c) zbaton dhe përkrah/mbështet linjën e veprimit dhe strategjinë kombëtare, si dhe mbikëqyr

realizimin e saj;

ç) mbështet, mbron, zhvillon dhe promovon burimet turistike, kulturën dhe trashëgiminë materiale e jomateriale të popullit shqiptar, në përputhje me linjën e veprimit dhe në bashkëpunim me institucionet qendrore, vendore, sektorin privat të turizmit dhe shoqërinë civile.

Neni 7

Komiteti Ndërmintor për Turizmin

1. Komiteti Ndërmintor për Turizmin, në vazhdim KNT, është një organ këshillimor i Këshillit të Ministrave, sipas nenit 11 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

2. Komiteti Ndërmintor për Turizmin, përveç detyrave të tjera që mund t'i caktohen në aktin e krijimit, shqyrton:

a) strategjitë e zhvillimit të turizmit në Republikën e Shqipërisë dhe planet e veprimit në nivel kombëtar dhe në zonat pilot për zhvillimin e turizmit;

b) orienton politikat për zhvillimin e një industrie të qëndrueshme të turizmit në Republikën e Shqipërisë, në funksion të zbatimit të standardeve.

Neni 8

Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit

1. Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit, në vazhdim KKSPT, krijohet si një organ këshillimor për këtë sektor, që funksionon në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin. Veprimtaria e KKSPT-së zhvillohet në përputhje me rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

2. KKSPT-ja kryesohet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe në përbërje të tij ka përfaqësues nga të gjitha shoqatat kombëtare profesionale të operatorëve e agjentëve të udhëtimit, hoteleve, njësive akomoduese, guidave turistike dhe sipërmarrjeve të tjera turistike që operojnë në fushën e turizmit, si dhe institucione/donatorë ndërkombëtarë.

3. KKSPT-ja ka këto detyra:

a) trajton dhe shqyrton çështje që kanë lidhje me veprimtarinë turistike të sektorit privat ose që mund të dalin gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie;

b) siguron bashkëpunim ndërmjet sektorit privat dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin për çështje që mund të lindin gjatë zhvillimit të turizmit, zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Turizmit dhe planit të veprimit;

c) jep informacione për sektorin privat të turizmit dhe i sugjeron ministrisë përkatëse marrjen e masave për çështje që kanë të bëjnë me turizmin.

Neni 9

Agjencia Kombëtare e Turizmit

1. Agjencia Kombëtare e Turizmit, në vazhdim AKT, krijohet si ent publik buxhetor, me statusin e personit juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin.

2. AKT-ja ka si objekt dhe qëllim:

a) të përkrahë/ndihmojë dhe të mbështesë sigurimin e financimit për personat juridikë e fizikë, që kryejnë ose kanë qëllim të kryejnë sipërmarrje turistike;

b) të hartojë programet e asistencës financiare për projektet turistike, të cilat, nëpërmjet ministrit përgjegjës për turizmin, ia paraqet komisionit të ndihmës shtetërore, në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”;

c) të menaxhojë fondin kombëtar të zhvillimit të turizmit, në përputhje me programin e miratuar të asistencës financiare;

ç) të inspektojë dhe të garantojë zbatimin e kushteve, në bazë të të cilave u është dhënë asistencë financiare personave që kryejnë sipërmarrje turistike;

d) të kontrollojë zbatimin dhe plotësimin e kriterëve për marrëveshjet ekzistuese të qirasë dhe për marrëveshjet e zhvillimit, të lidhura me subjektet;

dh) të sigurojë ose të ndihmojë në sigurimin e shërbimeve e të lehtësive për biznesin privat të turizmit, nëpërmjet tarifave të miratuara për këto shërbime;

e) të administrojë të ardhurat që realizohen nga shërbimet e ofruara ndaj biznesit turistik dhe që përfitohen nga grantet/donacionet apo burime të tjera financimi të ligjshme;

ë) të kryejë funksionet që kanë lidhje me promocionin dhe marketingun në fushën e turizmit dhe funksione të tjera të përcaktuara në këtë ligj.

3. Statuti i AKT-së, organizimi, mënyra e funksionimit dhe kompetencat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Drejtori i AKT-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga ministri përgjegjës për turizmin, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Neni 10

Struktura dhe organika e AKT-së

Struktura dhe organika e AKT-së përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 11

Komisioni i Standardeve të Turizmit

1. Komisioni i Standardeve të Turizmit, në vazhdim KST, është një strukturë që shqyrton kërkesat për marrjen e certifikatave, si dhe kërkesat për marrje, ripërtëritje, transferim dhe/apo heqje licence dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për turizmin, sipas nenit 28 të këtij ligji.

2. Organizimi i këtij komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të tij miratohen me urdhër të veçantë të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Rregullorja e funksionimit të këtij komisioni miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Në asnjë rast anëtarët e KST-së nuk duhet të kenë konflikt interesash me subjektet që kërkojnë të licencohen. Në të kundërt, veprohet në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7. 4. 2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave” dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 12

Zyra e Shërbimit Turistik

1. Zyra e Shërbimit Turistik, më tej ZSHT, krijohet si person juridik publik dhe si strukturë buxhetore në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin, me objekt të veprimtarisë dhënien e informacionit për turistët, për hyrjen, shërbimet dhe lehtësitë e mundshme për vendet dhe pikat me interes për turistët, si dhe shqyrtimin e trajtimit e ankesave të shtetasve, vendas ose të huaj, kundrejt hotelierëve, pronarëve të restoranteve, guidave turistike, agentëve të udhëtimit, organizatorëve turistikë dhe sipërmarrjeve të tjera turistike për mallrat dhe shërbimet e ofruara nga ata.

2. ZSHT-ja është e organizuar në degë rajonale të shtrira në bazë qarku.

3. Struktura dhe organika e ZSHT-së miratohen nga ministri përgjegjës për turizmin.

4. Rregullorja e shqyrtimit dhe e trajtimit të ankesave miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 13

Drejtimi dhe kompetencat e ZSHT-së

1. ZSHT-ja drejtohet nga drejtori, i cili emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga ministri

përgjegjës për turizmin, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

2. ZSHT-ja ka këto kompetenca:

- a) jep informacion për turistët për vendet dhe pikat turistike, si dhe shpërndan broshura për shërbimet turistike që ofrohen në këto vende e pika;
- b) regjistron dhe krijon bazën e të dhënave për hyrjet e turistëve dhe mban statistika për numrin e vizitorëve dhe vendet e pikat turistike më të frekuentuara;
- c) mbledh dhe harton, në bashkëpunim me nëpunësit e turizmit të njësisë të qeverisjes vendore, raporte periodike statistikore, të cilat ia paraqet ministrit dhe kryen inspektim për regjistrimin e klientëve;
- ç) regjistron çdo kërkesë dhe ankesë që paraqitet nga turistët, përfaqësues të tyre dhe nga shoqatat konsumatore dhe evidenton të metat dhe shkeljet e konstatuara nga subjektet e ndryshme të dispozitave të këtij ligji;
- d) bashkëpunon me strukturat e rendit publik dhe jep informacionin e nevojshëm për rastet që janë në kompetencë të organeve të rendit, për të ndërhyrë sa herë që cenohen siguria dhe jeta e turistëve;
- dh) merr pjesë gjatë trajtimit të ankesave të shtetasve, vendas apo të huaj, ndaj hotelierëve, pronarëve të restoranteve, guidave turistike, agjentëve të udhëtimit, organizatorëve turistikë dhe sipërmarrjeve të tjera turistike për shërbimet e ofruara;
- e) bën, për çdo ankesë, verifikimet përkatëse dhe, në bazë të fakteve, vepron si më poshtë:
 - i) hedh poshtë ankesën e turistit;
 - ii) urdhëron subjektet e përmendura në shkronjën “dh” të kësaj pike të dëmshpërblejnë, plotësisht ose pjesërisht, klientin që është ankuar;
 - iii) urdhëron pronarin e sipërmarrjes turistike të kompensojë klientin;
 - iv) mban procesverbalin përkatës, i cili nënshkruhet nga palët dhe vendos gjobën përkatëse për kundërvajtësin.

Neni 14

Kompetencat e drejtorit të ZSHT-së

Drejtori i ZSHT-së ka këto kompetenca:

- a) drejton veprimtarinë e kësaj zyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;
- b) mbikëqyr zbatimin nga subjektet dhe sipërmarrësit turistikë të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- c) vendos gjobat ndaj personave fizikë/juridikë, subjekte të këtij ligji, kur vëren kundërvajtje administrative;
- ç) zbaton detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara nga ministri përgjegjës për turizmin, në përputhje me rregulloren e trajtimit të ankesave, sipas pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 15

Njësitë e qeverisjes vendore dhe detyrat e tyre për turizmin

Njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të këtij ligji, kanë detyrë:

- a) të krijojnë inventarin e burimeve kryesore turistike të njësisë së qeverisjes vendore dhe inventarin e bizneseve turistike në nivel vendor;
- b) të përcjellin, në mënyrë periodike, dy herë në vit, inventarët e mësipërm pranë ministrit përgjegjës për turizmin, për krijimin e bazës së të dhënave në nivel kombëtar;
- c) të japin asistencë teknike për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve turistike, në përputhje dhe në zbatim të këtij ligji;
- ç) të mbikëqyrin zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të tjera ligjore nga subjektet private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit dhe të propozojnë masat përkatëse për institucionet.

KREU IV

PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Neni 16

Klasifikimi i burimeve turistike

1. Burimet turistike në Republikën e Shqipërisë klasifikohen në:
 - a) burime natyrore turistike, ku përfshihen pejzazhet natyrore, zonat e mbrojtura, veçoritë gjeografike e biologjike, kushtet klimatike, detare, hidrografike dhe objektet e tjera fizike, natyrore apo gjeomumentale, që janë tërheqëse për turistët;
 - b) burime njerëzore turistike, që ndahen në:
 - i) burime materiale njerëzore turistike, ku përfshihen ndërtesat historike, reliket e ndërtimet e tjera, si dhe artifaktet;
 - ii) burime jomateriale njerëzore turistike, që nënkupton veprimtaritë e ndryshme kulturore.
2. Burimet turistike përfshijnë si ato që shfrytëzohen në mënyrë tregtare, edhe ato që nuk përdoren në këtë mënyrë.

Neni 17

Regjistri kombëtar i burimeve turistike

1. Ministria përgjegjëse për turizmin harton dhe administron regjistrin kombëtar të burimeve turistike.
2. Ministria përgjegjëse për turizmin identifikon, inventarizon dhe promovon burimet turistike, nëpërmjet sigurimit të të dhënave të lidhura me to, që kanë organet publike të qeverisjes qendrore apo vendore, të caktuara për administrimin e burimeve turistike.
3. Përditëson çdo vit të dhënat në regjistrin kombëtar të burimeve turistike.
4. Pronarët ose organet administruuese të burimeve turistike regjistrojnë burimet turistike në regjistrin kombëtar të burimeve turistike.

Neni 18

Përgjegjësia për administrimin e burimeve turistike

1. Personat juridikë dhe fizikë, organet publike qendrore dhe vendore apo personat privatë, që zotërojnë ose administrojnë burime turistike, janë përgjegjës për administrimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të lidhura me të.
2. Organet e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për bashkërendimin e punës së bashkive, komunave dhe organeve publike, të angazhuara në zhvillimin e turizmit brenda territorit të tyre, për mbrojtjen, rritjen dhe përdorimin e burimeve turistike për maksimizimin e potencialit ekonomik të tyre, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

Neni 19

Mbështetja për zhvillimin e turizmit

Organet shtetërore, në bashkëpunim dhe në kujdesin e ministrit e të ministrisë përgjegjëse për turizmin, ndihmojnë zhvillimin e turizmit:

- a) duke hartuar planet e zhvillimit të turizmit për çdo bashki dhe komunë;
- b) duke dhënë informacion turistik dhe duke organizuar veprimtari arsimuese dhe promovimi;
- c) duke marrë masa për zhvillimin e infrastrukturës dhe krijimin e lehtësive në zonat e zhvillimit turistik, fshatrat turistike, zonat turistike, vendet turistike dhe pikat turistike;
- ç) duke mbështetur investimet në turizëm në zonat e thella malore dhe me popullsi të rrallë;
- d) duke propozuar politika të lehtësive fiskale për bizneset turistike, për individët dhe subjektet juridike në zonat e zhvillimit turistik, fshatrat turistike, vendet dhe pikat turistike, që

veprojnë në sipërmarrjet turistike.

Neni 20

Përcaktimi i zonave, i vendeve dhe i pikave turistike

Përcaktimi i zonave, i vendeve dhe i pikave turistike bëhet në bazë të masterplanit kombëtar të zhvillimit të turizmit, të regjistrit të burimeve turistike dhe planifikimit të zhvillimit ekonomiko-social të tyre.

Neni 21

Procedura për përcaktimin e një fshati turistik dhe lehtësitë e përfitimit të asistencës financiare

1. Standardet, kriteret dhe procedurat për përcaktimin dhe njohjen e një fshati turistik parashikohen në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Propozimi për njohjen e një fshati turistik paraqitet nga organet e qeverisjes vendore, AKT-ja dhe/ose nga persona juridikë publikë ose privatë te ministri përgjegjës për turizmin dhe përmban këto dokumente:

a) raportin për përmbushjen e standardeve dhe të kriterëve të përcaktuara në rregullore, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni dhe standardet e kriteret mjedisore të ndikimit në mjedis, sipas legjislacionit në fuqi;

b) një kopje të planit të hollësishëm të zhvillimit të turizmit;

c) planin, ku identifikohen burimet njerëzore, infrastruktura dhe shërbimet teknike në dispozicion dhe projektet për zhvillimin e tyre në të ardhmen;

ç) planin e terrenit të rezervuar për zgjerim dhe krijim të fshatit turistik.

3. Procedura për njohjen e një fshati turistik nuk duhet të kalojë 60 ditë nga depozitimi i kërkesës dhe i dosjes përkatëse në ministrinë përgjegjëse për turizmin. Pas mbarimit të këtij afati, kërkesa quhet e miratuar.

4. Përfitimi i lehtësive dhe i asistencës financiare për një fshat turistik bëhet në përputhje me përcaktimet e procedurave të përmendura në nenin 26 të këtij ligji.

Neni 22

Planifikimi i zhvillimit të turizmit

1. Planifikimi i zhvillimit të turizmit bëhet në bazë të:

a) regjistrit kombëtar të burimeve turistike;

b) planeve, në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe komune, për zhvillimin e turizmit;

c) orientimit ndaj zonave të zhvillimit turistik dhe aty ku zhvillimi turistik është në gjendje të nxisë rristurimin social-ekonomik.

2. Planet për zhvillimin e turizmit shqyrtohen dhe rishihen periodikisht, për të siguruar përputhshmëri me situatën e zhvillimit social-ekonomik në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe komune.

Neni 23

Përmbajtja e planeve të zhvillimit të turizmit

Planet e zhvillimit të turizmit përgatiten në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Këto plane përmbajnë:

a) parashikimet për zhvillimin e turizmit dhe përcaktimin e zonave të veçanta për këtë qëllim;

b) vlerësimin e kapitalit të investimit të investitorëve të ndryshëm, në përputhje me planet në nivel kombëtar, bashkie dhe komune, të zhvillimit për një periudhë prej 5 vjetësh, 10 vjetësh ose më gjatë;

c) parashikimet e planit të punimeve në infrastrukturën e zonës, të vendeve dhe pikave turistike, në përputhje me potencialin turistik dhe planet e zhvillimit social-ekonomik kombëtar, rajonal dhe vendor;

- ç) parashikimet e veprimtarive të promocionit dhe marketingut;
- d) parashikimet e veprimtarive arsimuese dhe të vazhdimësisë së zhvillimit profesional.

Neni 24

Hartimi i planeve hapësinore për zhvillimin e turizmit

1. Hartimi i planeve hapësinore për zhvillimin e turizmit duhet të mbështetet në strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe të sigurojë zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm turistik.
2. Miratimi dhe kontrolli i planeve të zhvillimit hapësinor, që kryhet nga institucionet përkatëse, sipas ligjeve përkatëse për urbanistikën, duhet të sigurojë përputhjen me objektivat strategjike të zhvillimit të turizmit.

KREU V

FONDI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT DHE PROGRAMET E ASISTENCËS FINANCIARE

Neni 25

Fondi i zhvillimit të turizmit

1. Krijohet fondi i zhvillimit të turizmit, si pjesë e programit të zhvillimit të turizmit, i cili administrohet nga AKT-ja, për sigurimin dhe përmirësimin e zhvillimit të sektorit të turizmit, duke promovuar mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave, të vendeve dhe pikave turistike, vlerat e trashëgimisë kulturore dhe mbështetjen e profesionalizmit në sektorin e turizmit.

2. Përveç Buxhetit të Shtetit, fondi i zhvillimit të turizmit shfrytëzon edhe burime të tjera financiare, si:

- a) tarifat për licencat e dhëna nga ministri përgjegjës për turizmin, në përputhje me këtë ligj;
- b) të ardhurat nga qiratë e trojeve, sipas marrëveshjeve të lidhura me subjektet që zhvillojnë veprimtari turistike, sipas akteve nënligjore në fuqi;
- c) donacionet nga organizatat jofitimprurëse dhe subjekte të tjera, sipas marrëveshjeve të lidhura mes tyre dhe ministrisë.

3. Këshilli i Ministrave miraton mënyrën e përdorimit të fondit të zhvillimit të turizmit.

Neni 26

Programet e asistencës financiare për sipërmarrjet dhe projektet turistike

1. Ministria, nëpërmjet AKT-së, përgatit programe për sigurimin e asistencës financiare për realizimin e projekteve.

2. Këto programe duhet të jenë në përputhje me objektivat e këtij ligji dhe të sigurojnë e të përmirësojnë sektorin e turizmit, të mbrojnë, të ruajnë dhe të promovojnë vendet turistike dhe vlerat e trashëgimisë kulturore, të mbështesin, të përkrahin ose të mundësojnë zhvillimin e veprimtarive kulturore, si dhe të mbështesin profesionalizmin në sektorin e turizmit.

3. Asistenca financiare për këto programe mund të jepet në formë granti, huaje ose përjashtimi nga taksat apo si një kombinim i tyre.

4. Kushtet dhe kriteret për përfitimin e asistencës financiare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 27

Organizimi i kontrollit për mënyrën e përdorimit të granteve, huave dhe përfitimeve të tjera financiare

1. Çdo person ose strukturë e autorizuar nga ministri për zhvillimin e turizmit ka të drejtë, në çdo kohë, të inspektojë subjektin që zhvillon veprimtari turistike, i cili ka përfituar nga grantet, huatë ose taksat e përmendura në pikën 3 të nenit 26 të këtij ligji, për të parë nëse janë përdorur në përputhje

me kushtet e përcaktuara në pikën 4 të nenit 26 të këtij ligji.

2. Nëse subjekti, që ka përfituar asistencë financiare, nuk ka zbatuar kushtet e përcaktuara për përdorimin e saj, ministri përgjegjës për turizmin ka kompetencë të vendosë, përveç gjobave të përcaktuara në nenin 45 të këtij ligji, edhe ndërprerjen e asistencës financiare, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

KREU VI STANDARDET DHE LICENCIMI

Neni 28

Standardet e sipërmarrjeve turistike

1. Standardet, kriteret, rregullat e licencimit, procedurat për aplikim, ripërtëritje, transferim dhe heqje licence në fushën e turizmit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

2. Licencimi për ushtrimin e veprimtarisë së turizmit bëhet nga ministri përgjegjës për turizmin.

Neni 29

Kategorizimi

KST-ja, pasi shqyrton kërkesat e personit fizik e juridik, vendas e të huaj, i pajis ata me:

- a) certifikatë për hotele dhe njësi akomodimi, për drejtimin e biznesit në ndërtesat e përcaktuara në të;
- b) licencë për guidë turistike.

KREU VII HOTELET, NJËSITË AKOMODUESE DHE RESTORANTET TURISTIKE

Neni 30

Kriteret e ndërtimit të njësive akomoduese dhe të restoranteve turistike

1. Ministri përgjegjës për turizmin miraton rregulloren përkatëse të kërkesave për projektimin dhe ndërtimin e njësive akomoduese e të restoranteve turistike, e cila është e detyrueshme të përfshihet në rregulloret e ndërtimit nga institucionet përkatëse.

2. Nuk jepet asnjë lloj certifikate për hotelet apo njësi të tjera akomoduese që nuk plotësojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 31

Regjistrimi dhe klasifikimi i hoteleve, njësive akomoduese dhe i restoranteve turistike

1. Ministri përgjegjës për turizmin përcakton në rregullore kërkesat për:

- a) regjistrimin e hoteleve apo të njësive akomoduese, ku ofrohet akomodim fjetjeje, për qëllime tregtare apo biznesi;
- b) regjistrimin e restoranteve për turistë;
- c) klasifikimin e hoteleve, njësive të akomodimit dhe të restoranteve turistike.

2. Ministri përgjegjës për turizmin siguron një shpjegues të kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 32

Inspektimi i hoteleve, njësive akomoduese, restoranteve dhe sipërmarrjeve të tjera turistike

1. Ministria përgjegjëse për turizmin, nëpërmjet strukturës përkatëse, me njoftim me shkrim, mund t'i kërkojë çdo personi që drejton një hotel ose njësi tjetër akomodimi për turistë, një restorant apo sipërmarrje turistike:

- a) lejinin e nëpunësit të autorizuar për inspektim të hyjë në mjediset ku zhvillohet biznesi;
- b) informacion, në formë raportesh, sipas specifikimit në njoftimin me shkrim.

2. Ministria përgjegjëse për turizmin bashkëpunon me organe të tjera publike për të shmangur mbivendosje inspektimesh.

Neni 33

Detyrimi për ekspozimin e emrit të biznesit dhe detyrime të tjera

1. Çdo sipërmarrje turistike ka detyrimin të ekspozojë në vend të dukshëm për publikun emrin e biznesit, si dhe procedurën e ankimit, e cila duhet të jetë në shqip dhe në anglisht.

2. Çdo sipërmarrje turistike ka detyrimin të shënojë në të gjitha faturat, letërkëmbimet, dëftesat, raportet dhe broshurat që përdor emrin e biznesit/shoqërisë.

3. Çdo njësi akomoduese, restorant turistik apo agjenci turistike duhet të ekspozojë dukshëm listat e çmimeve për produktin dhe shërbimin që ofron.

4. Çdo njësi akomoduese apo restorant turistik mban përgjegjësi, për sa kohë që klienti qëndron atje, për sigurimin e jetës së tij, të standardeve të shërbimit që ai ofron dhe për çdo dëm të shkaktuar në shëndetin, sigurinë dhe pronën e klientit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 34

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore

1. Përpunimi i të dhënave statistikore duhet të përfshijë kapacitetin e njësive akomoduese, numrin e turistëve e të ekskursionistëve, numrin e netëve të qëndrimit dhe informacion për kërkesën e tregut turistik.

2. Të dhënat statistikore duhet të jenë të vërteta, cilësore dhe të disponueshme për t'iu transmetuar subjekteve të interesuara brenda dhe jashtë vendit.

3. Hotelieri apo çdo pronar i njësisë akomoduese duhet të sigurojë nga çdo person, që strehohet ose fle në hotel për të paktën një natë, emrin e plotë, adresën e banimit, kombësinë ose nënshtetësinë, numrin dhe vendin e lëshimit të pasaportës dhe përpara largimit nga hoteli edhe destinacionin e ardhshëm apo adresën, nëse dihet prej tij.

Këto të dhëna shënohen në formularët përkatës dhe i dorëzohen çdo muaj Zyrës së Shërbimit Turistik.

4. Hotelieri apo çdo pronar i njësisë akomoduese mban një raport me shkrim të informacionit të dhënë, sipas këtij neni, i cili duhet të jetë i hapur për inspektim nga nëpunësi i ministrisë, i caktuar për të inspektuar, ose nga nëpunësi i ZSHT-së në qarqe dhe qendër.

5. Procedurat e mbledhjes, përpunimit, dhënies së të dhënave dhe standardizimi i tyre përcaktohen në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

KREU VIII

AGJENTËT E UDHËTIMIT DHE OPERATORËT TURISTIKË

Neni 35

Agjentët e agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë

Ministri përgjegjës për turizmin, me propozimin e strukturës përkatëse, miraton, me urdhër të veçantë, kriteret dhe rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së agjentëve e agjencive të udhëtimit e të operatorëve turistikë, ku parashikohen:

- a) kërkesat dhe testimet për agjentët/agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë;
- b) përgatitjet dhe lehtësitë për personat që përfitojnë shërbimin;
- c) elementet e kontratës për shitjen ose ofrimin e paketës turistike;

- ç) përcaktimin për reklamimin e shërbimeve turistike;
- d) detyra për të ofruar një shërbim të caktuar turistik, përmes personave të kualifikuar.

Neni 36

Shoqëruesi dhe eksperti i udhëtimit

1. Ministri përgjegjës për turizmin, me rregullore, përcakton procedurat dhe kriteret për dhënien e certifikatës së shoqëruesit dhe të ekspertit të udhëtimit.
2. Çdo agjent udhëtimi duhet të ketë të punësuar shoqërues udhëtimi, të pajisur me certifikatën përkatëse.
3. Një agjent/agjenci udhëtimi ka të drejtë të punësojë një person, që nuk ka certifikatën e shoqëruesit të udhëtimit, për një periudhë prove njëvjeçare.
4. Ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me institucionet e tjera publike, arsimore dhe profesionale, mundëson ofrimin e kurseve trajnuese njëvjeçare, në bazë të programeve të hartuara dhe të testimeve përkatëse, për personat e kualifikuar, në përputhje me ligjin nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional”.
5. Personat e pajisur me certifikatën e shoqëruesit të udhëtimit, me përvojë trevjeçare në atë pozicion ose pesëvjeçare në një pozicion të njohur nga drejtuesi, kanë të drejtë të marrin certifikatën e ekspertit të udhëtimit.
6. Për shoqëruesit dhe ekspertët e udhëtimit, të cilët janë pajisur, përkatësisht, me certifikatë nga institucionet arsimore-profesionale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, njësimi dhe njohja e certifikatës përkatëse bëhet në përputhje me rregullat dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 37

Vazhdimësia e zhvillimit profesional

1. Ministria përgjegjëse për turizmin organizon kurse të vazhdueshme zhvillimi profesional dhe seminare për administratorët, menaxherët, ekspertët e udhëtimit, shoqëruesit e udhëtimit dhe punonjësit e tjerë të agjencive të udhëtimit dhe të operatorëve turistikë.
2. Ministria përgjegjëse për turizmin krijon një strukturë të formimit profesional, në përputhje me ligjin nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional”.

Neni 38

Detyrat dhe përgjegjësitë e agjentëve e agjencive të udhëtimit dhe të operatorëve turistikë

1. Drejtuesi i një agjencie udhëtimi ose operatori turistik, menaxherët dhe nëpunësit e tyre duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të përmbushin detyrimet e mëposhtme:
 - a) të japin informacion të saktë dhe të paanshëm, për të mundësuar që klientët e tyre të ushtrojnë gjykim të bazuar në informacion në blerjen e shërbimeve, paketës turistike, si dhe të vënë në dispozicion broshurat e udhëtimit dhe literaturë tjetër, që ka lidhje me shërbimet që ofrohen për klientët e tyre;
 - b) reklamat, dokumentet apo botimet, me shkrim ose në formë tjetër, nuk duhet të kenë në përmbajtje të dhëna të rreme që mashtrojnë publikun. Ato duhet të përmbajnë çmimet dhe informacionin e përshtatshëm për klientët;
 - c) kur bëhen ndryshime gjatë përgatitjeve të turit ose udhëtimit, duhet të vënë në dijeni menjëherë klientët, që ata të këshillohen për situatën dhe të vendosin si duhet të veprojnë;
 - ç) çdo çështje, që lidhet me përshkrimin e paketës turistike, çmimin e paketës dhe çdo kushtëzim tjetër, të dhënë në kontratën e lidhur me klientin, nuk duhet të përmbajë informacion të paqartë;
 - d) të sigurojnë për klientin, përpara mbylljes së kontratës, informacion të përgjithshëm për procedurat e marrjes së vizave, sipas rastit të aplikuar, formalitetet shëndetësore, kohën, vendin e ndalesave ndërmjetëse dhe lidhjet e transportit, si dhe të dhëna për emrin dhe numrin e telefonit të agjentit vendor;
 - dh) në rastin e udhëtimeve të minorenëve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të

sigurojnë informacion dhe vendosjen e kontaktit me personat përgjegjës të tyre në vendin e banimit;

e) të mbajnë përgjegjësi për çdo dëmtim të interesave të klientëve, që vijnë si rezultat i dobësive të shërbimit dhe t'i kompensojnë ata sipas masës së dëmit të shkaktuar.

2. Operatorët turistikë, përveç detyrimeve të dhëna në pikën 1 të këtij neni, duhet:

a) të japin, për çdo shërbim të blerë, një faturë, biletë ose vërtetim, që përmban një numër progresiv, si provë pagese, ndërsa kopje të këtyre dokumenteve duhet të mbahen për të paktën një vit nga data e lëshimit;

b) të mbajnë një raport të ankesave në ndërtesën ku ofrohen shërbimet.

3. Agjentët e udhëtimit, përveç detyrimeve të dhëna në pikën 1 të këtij neni, duhet:

a) të vënë në dijeni klientët e tyre përpara se të bëhet ndonjë kontratë rezervimi për kushte të tjera të publikuara, që vlejnë për përgatitjet e paketës së tyre të udhëtimit;

b) të sigurohen se klientëve të tyre u janë shitur ture, akomodime dhe përgatitje për udhëtime, në përputhje me kërkesat e tyre individuale.

Neni 39

Regjistrimi i udhëtimeve

1. Një operator turistik, që merr një automjet turizmi për ta shfrytëzuar për turizëm, plotëson një raport me shkrim ose dosje të kompjuterizuar të specifikuar, brenda 14 ditëve nga përfundimi i udhëtimit turistik, për çdo ditë të përdorimit të automjetit, sipas formularit të miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

2. Operatori turistik duhet të mbajë raporte ose dosje të kërkuara për tre vjet, që nga data e kthimit nga udhëtimi, të specifikuara dhe siç kërkohet në këtë nen.

Neni 40

Mosmarrëveshjet me klientët

Në rast mosmarrëveshjeje me klientin, operatori turistik ose agjenti i udhëtimit duhet:

a) të bëjë çdo përpjekje për të arritur në një zgjidhje me marrëveshje dhe të shpejtë me klientët;

b) të sigurojë që çdo korrespondencë të trajtohet brenda periudhave kohore të mëposhtme:

i) jo më vonë se 14 ditë nga data e marrjes së kërkesës/ankesës nga klienti;

ii) jo më vonë se 28 ditë nga data e marrjes së njoftimit për një përgjigje të hollësishme për t'ia dërguar klientit.

KREU IX

TRANSPORTI TURISTIK DHE SIPËRMARRJET E TJERA TURISTIKE

Neni 41

Rregullat për transportin turistik

1. Me propozimin e strukturës përgjegjëse në ministri, ministri miraton rregullat specifike për kategorizimin e subjekteve që ofrojnë transport turistik udhëtarësh tokësor, ajror e ujor, pasi të kenë marrë licencën përkatëse nga ministria përgjegjëse e transporteve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Komisioni i Standardeve të Turizmit, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës, i propozon ministrit dhënien ose refuzimin e kategorizimit subjektit kërkuar.

2. Rregullorja specifike për kategorizimin e transportit turistik duhet të përmbajë:

a) kriteret për klasifikimin e automjeteve për transport turistësh;

b) kualifikimin e shoferit;

c) kërkesat e sigurisë për automjetin dhe funksionimin e tij;

ç) ofrimin e shërbimeve dhe të lehtësive të duhura për pasagjerët;

d) dispozita për reklamimin e shërbimit;

dh) detyrat për ekspozimin e çmimeve;

e) kushte të tjera, të cilat vlerësohen të nevojshme për transport turistik udhëtarësh.

Neni 42
Guida turistike

1. Ministria, në bashkëpunim me institucionet e tjera publike, arsimore dhe profesionale, mundëson ofrimin e kurseve trajnuese njëvjeçare, në bazë të programeve të hartuara dhe të testimëve përkatëse për personat që kualifikohen në këtë profesion, në përputhje me ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional”.

2. Me propozimin e KST-së, ministri miraton kualifikimet minimale dhe kriteret që duhet të përmbushin subjektet për t'u licencuar si guidë, në përputhje me fushën dhe profilin e duhur dhe lëshon certifikatat profesionale.

Neni 43
Detyrat dhe përgjegjësitë e guidës turistike

Guidat turistike kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) japin informacion të saktë dhe të paanshëm për t'u mundësuar klientëve të tyre një gjykim, bazuar në informacionin për blerjen e një udhëtimi ose të shërbimeve të tjera;
- b) vënë në dijeni klientët për ndonjë rrezik shëndetësor ose sigurie gjatë udhëtimit të propozuar;
- c) nuk duhet të jenë udhërrëfyes, nëse ngasin makinën, autobusin ose automjetet e tjera për turistët;
- ç) informacioni që japin për klientët e tyre gjatë drejtimit të një udhëtimi duhet të jetë i saktë dhe profesional;
- d) duhet të kenë informacione, broshura etj. të guidave turistike, ndërsa janë në detyrë dhe të kenë një stemë ose shenjë dalluese si guidë;
- dh) duhet të demonstrojnë etikë profesionale dhe qytetare në shërbimin ndaj klientëve;
- e) nuk lejohet t'i kërkojnë klientit përqindje ose përfitim, përveç sa është parashikuar në kontratën e shërbimit dhe për çmimin e ekspozuar dhe rënë dakord.

Neni 44
Sipërmarrjet e tjera turistike

Sipërmarrjet e tjera turistike, dyqanet e suvenireve dhe të prodhimeve artizanale në vendet dhe pikat turistike, për funksionimin e tyre duhet të plotësojnë kriteret të përcaktuara nga ministri përgjegjës për turizmin.

KREU X
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 45
Rastet e kundërvajtjeve administrative

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë si më poshtë:

- 1. Shkelja e përcaktuar në pikën 1 të nenit 27 të këtij ligji ndëshkohet me 500 000 lekë gjobë.
- 2. Shkelja e përcaktuar në pikat 1 e 2 të nenit 31 të këtij ligji ndëshkohet me 20 000 lekë gjobë.
- 3. Shkelja e përcaktuar në pikat 1, 2 e 3 të nenit 33 të këtij ligji ndëshkohet me 10 000 lekë gjobë.
- 4. Shkelja e përcaktuar në pikën 3 të nenit 34 të këtij ligji ndëshkohet me 20 000 lekë gjobë.
- 5. Shkelja e përcaktuar në pikat 1 e 2 të nenit 39 të këtij ligji ndëshkohet me 50 000 lekë gjobë.

Neni 46
Ankimi

1. Kundërvajtësi, brenda 10 ditëve nga vënia e gjobës, bën ankim në ZSHT-në që ka vendosur gjobën, e cila shqyrton ankimin dhe, brenda 5 ditëve, njofton subjektin ankues.

2. Kundër vendimit të titullarit të ZSHT-së, subjekti mund të bëjë ankim brenda 7 ditëve në ministrinë përgjegjëse për turizmin. Ankimi shqyrtohet nga një komision ad-hoc, i ngritur me urdhër të ministrit. Vendimi për lënien në fuqi të gjobës ose shfuqizimin e saj i jepet subjektit brenda 14 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

3. Kundër vendimit të komisionit të shqyrtimit të gjobave, subjekti mund t'i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor ku ushtron veprimtarinë.

Neni 47

Të ardhurat nga vendosja e gjobave

Të ardhurat e krijuara nga vendosja e gjobave kalojnë në masën 40 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe ndahen sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave e ministrit përgjegjës për turizmin dhe 60 për qind e tyre në buxhetin e pushtetit vendor ku ato realizohen.

KREU XI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 48

Dispozita kalimtare

1. Për subjektet, që kanë lidhur marrëveshje qiraje dhe zhvillimi me ministrinë përgjegjëse për turizmin, sipas ligjit nr. 7665, datë 21. 1. 1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar, të zbatohen dispozitat e Kodit Civil. Periudha e përfitimit të stimujve të vazhdojë të llogaritet sipas afateve të përcaktuara në marrëveshjet e qirasë dhe të zhvillimit. Strukturat turistike të ndërtuara të verifikohen nëse janë në përputhje me përcaktimet e bëra në marrëveshjet, standardet për licencimin dhe kategorizimin e tyre. Në të kundërt marrëveshjet do të zgjidhen në mënyrë të njëanshme.

2. Deri në krijimin e AKT-së, përgjegjësitë dhe kompetencat për kontrollin e zbatueshmërisë së marrëveshjeve do t'i ushtrojë ministria përgjegjëse për turizmin, nëpërmjet Entit të Turizmit.

3. Subjektet turistike, që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit, janë të detyruara të reregjistrohen dhe të licencohen pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, brenda një viti nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 49

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9 pika 3, 25 pika 3, 26 pika 4 e 28 pika 1.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për turizmin që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8 pika 1, 9 pika 3, 11, 12 pika 4, 21 pika 1, 30 pika 1, 31, 34 pika 5, 35 paragrafi i parë, 36 pika 1, 39 pika 1, 41 pika 1, 42 pika 2 dhe 44.

Neni 50

Shfuqizime

Ligji nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, shfuqizohen.

Neni 51

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5334, datë 31.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**